



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 tetor 2024
Nr. ref.: AGJ 2572/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI36/23

Parashtrues

“DONA-IMPEX” Sh.p.k.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
E. Rev. nr. 45/2021, të 10 nëntorit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga “DONA-IMPEX” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Ymer Bardhi, avokat në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 45/2021], të 10 nëntorit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ae. nr. 355/2019], e 8 marsit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [I. EK. nr. 624/18], e 30 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 1 dhe 2 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial. (Sqarim i Gjykatës: parashtruesi i referohet nenit 1 dhe nenit 2 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit, mirëpo përmbajtja e neneve të cekura 1 dhe 2, e të cilave iu referohet parashtruesi në shkresat e lëndës është analoge me përmbajtjen e neneve 1, 2, 4 dhe 5 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, miratuar dhe hapur për nënshkrim e ratifikim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2106 a (xx) të datës 21 dhjetor 1965, hyrë në fuqi më 4 janar 1969, në përputhje me nenin 19).
4. Gjithashtu parashtruesi pretendon edhe shkelje të nenit 2, paragrafit 1 (J) të nenit 4 si dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për atë sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 10 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 16 shkurt 2023, Kryetarja përmes Vendimit [Nr. GJR. KI36/23] dhe Vendimit [Nr. KSH. KI36/23], caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi – Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka – Nimani (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 28 shkurt 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
10. Më 24 gusht 2023, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme sqarime lidhur me vendimin e kontestuar, respektivisht lidhur me një paragraf i cili rezulton të jetë në kundërshtim me vet dispozitivin e tij.
11. Më 29 korrik 2023, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë sqarimet e kërkuara.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 29 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe vlerësoi se kërkesa ka nevojë për shqyrtim të mëtuajtëshëm dhe do të shqyrtohet sërish në një nga seancat e radhës.
14. Më 11 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësim në merita.
15. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri (i) konstatoi se kërkesa është e pranueshme; (ii) konstatoi se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) vendosi ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [E. Rev. nr. 45/2021], e 10 nëntorit 2022 të Gjykatës Supreme; (iv) ta kthejë për rishqyrtim Aktgjykimin [E. Rev. nr. 45/2021], e 10 nëntorit 2022, të Gjykatës Supreme, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 6 prill 2005, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur Kontratën mbi qiranë (nr. 03/706/1) me Ndërmarrjen Publike Banësore (në tekstin e mëtejme: NPB), për shfrytëzimin e lokalit afarist – depos, në sipërfaqe prej 257,50m², të cilin raport e kanë vazhduar me kontratat e 7 marsit 2006, 27 gushtit 2007, 15 shtatorit 2009, dhe në mënyrë të heshtur deri më 7 mars 2014.
17. Më 13 nëntor 2006, NPB parashtrroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), për pagesë borxhi për periudhën kontestuese (2005-2014) nga baza e kontratës mbi qiranë e lokalit afarist.

18. Më 19 maj 2008, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit me numër [2212/06], shpalli veten jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.
19. Më 14 mars 2014, Komisioni i NPB-së mbylli depon që ka qenë objekt i kontratës mbi qiranë, duke konstatuar se gjatë periudhës 2005-2014, borxhi i përgjithshëm i parashtruesit të kërkesës në emër të qirasë është në shumën prej 33.766,01 Euro.
20. Më 11 janar 2016, Gjykata Komunale lëndën ia ka referuar Gjykatës Themelore.

Procedura e parë në gjykatat e rregullta

21. Më 10 tetor 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [I. C. nr. 34/2016], miratoi në tërësi kërkesëpadinë e NPB-së që ndërlidhej me pagesë borxhi për periudhën kontestuese (2005-2014) nga baza e kontratës mbi qiranë e lokalit afarist.
22. Kundër Aktgjykimit të lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatë të Apelit, duke pretenduar konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 20 nëntor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ae. nr. 281/2016], (i) aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës; (ii) prishi Aktgjykimin [I. C. nr. 34/2016], e Gjykatës Themelore dhe lëndën e ktheu në rigjykim dhe rivendosje. Në aktvendimin e saj Gjykata e Apelit konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerrë në “*kundërshtim me nenin 8 të LPK-së pasi nuk ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe kështu edhe të gjitha së bashku*”.

Përmbledhja e fakteve që ndërlidhen me procedurën penale

24. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 15 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kallëzim penal kundër personit përgjegjës të NPB-së, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti “*në mënyrë absolutisht arbitrare dhe të njëanshme ka përpiluar Procesverbalin me numër Nr. 03-629 datë 11.03.2014, në të cilin Procesverbal në vendin dedikuar për nënshkrim nga "Pala" (në cilësinë e qiramarrësit), pa prezencën fizike dhe pa autorizimin e subjektit ekonomik denoncues, ka shkruar emrin, mbiemrin, adresën si dhe numrin e letërnjoftimit të denoncuesit .[E.K]. dhe kështu duke shfrytëzuar pozitën e tij dhe duke tejkalluar autorizimet ligjore që kishte, me qëllim të përfitimeve materiale pa të drejtë dhe në kundërshtim me ligjin të subjektit ekonomik Ndërmarrjes Publike Banesore - Prishtinë, i vetëdijshëm se duke vepruar në mënyrë absolutisht të kundërligjshme subjektit ekonomik denoncues "DONA - IMPEX" sh.p.k. - Prishtinë, do t'i shkactohej pa asnjë të drejtë dëm i pariparueshëm material me detyrimin e pagesës së qirasë edhe për periudhën kohore për të cilën Kompania denoncuese nuk ka shfrytëzuar assesi Depon në pronësi të Ndërmarrjes Publike Banesore - Prishtinë, kështu që duke vepruar në kundërshtim me ligjet në fuqi ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer,*
- *vepër penale nga neni 290 (keqpërdorim i autorizimeve ekonomike), vepër penale nga neni 335 (mashttrim), vepër penale nga neni 414 (keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar), vepër penale nga neni 426 (mashttrim në detyrë), si dhe vepër penale nga neni 434 (klasifikim i dokumentit zyrtar) të KODIT PENAL të Republikës së Kosovës*”.
25. Më 5 janar 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Prokurorinë Themelore në Prishtinë parashtruesën “*Urgjencë për përsheptim procedure*”, “*Pasi Ndërmarrja Publike Banesore*

- Prishtinë, me padi paraqitur para Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka filluar kontestin civil me bazë juridike: PAGESË QIRAJE bazuar në PROCESVERBALIN Nr.: 03-629 datë 10.03.2014, akt ky objekt i Kallëzimit Penal lëndor, është me interes ekzistencial për denoncuesin, "DONA - IMPEX" sh.p.k., Prishtinë, që Prokuroria Themelore të vendosi në mënyrë meritore vis a vis Kallëzimit Penal", duke i propozuar Prokurorisë që lënda në fjalë të përshpejtohet me urgjencë për shqyrtim dhe vendosje meritore.

26. Gjykata në shkresat e lëndës nuk ka informacione të tjera lidhur me veprimet e mëtutjeshme përkitazi me procedurën penale të lartpërmendur.

Procedura në rigjykim lidhur me kërkesëpadinë

27. Më 30 korrik 2019, Gjykata Themelore, duke vepruar në rigjykim, përmes Aktgjykimit [I. EK. nr. 624/2018], miratoi si të bazuar kërkesëpadinë e NPB-së, duke e detyruar parashtruesin e kërkesës që, nga baza e kontratës mbi qiranë e lokalit afarist – deposë, paditësit t'ia paguajë borxhin në shumë prej 33,766.01 Euro, me kamatë siç e aplikojnë bankat në Kosovë për mjetet e deponuara në afatin prej një viti, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga 18 maji 2016, e deri në pagesën definitive.
28. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj vlerësoi se në rastin konkret, megjithëse palët kanë qenë në raport kontraktues, parashtruesi i kërkesës nuk ka kryer plotësisht pagesat lidhur me borxhin e krijuar nga shfrytëzimi i depos dhe se lëshimi i rregullt i faturave nga paditësja dhe pranimi i faturave nga parashtruesi i kërkesës, ka efektin juridik të vazhdimit në heshtje të këtij raporti juridik – detyrimor, duke theksuar se parashtruesi i kërkesës: *"e ka pasur mundësinë që të deklarohet me anë të deklaratës së thjeshtë se e ka shkëputur raportin kontraktues dhe se depon në fjalë nuk është duke e shfrytëzuar ashtu siç e ka bërë me dt. 11.03.2014. Pretendimin e tij se përmes telefonit e ka njoftuar palën paditëse se nuk ka interes ta vazhdojë këtë raport kontraktues gjykata nuk e ka marrë për faktin se ka qenë vetëm deklarativ"*.
29. Nga shkresat e lëndës gjithashtu rezulton se Gjykata Themelore për të konstatuar lartësinë e borxhit kishte angazhuar edhe ekspertin financiar E.P. dhe nga ekspertiza rezulton se parashtruesi i kërkesës ka paguar një pjesë të faturave të pranuar, ndërsa si fatura të papaguara, respektivisht si borxh kishte konstatuar shumën prej 33,766.01 Euro.
30. Kundër Aktgjykimit të lartpërmendur, brenda afatit ligjor, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të: (i) shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që Aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.
31. Në një datë të pasaktësuar, NPB-ja ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim Gjykatës së Apelit, që ta hedhë si të pabazuar dhe të paargumentuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, kurse Aktgjykimin e Gjykatës Themelore ta mbajë në fuqi.
32. Më 8 mars 2021, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktgjykimit [Ae. nr. 355/19], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [I. EK. nr. 624/2018] e 30 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore.

33. Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, respektivisht dispozitat e nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është përcaktuar se *“pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, duke theksuar se në rastin konkret palët kanë qenë në raport kontraktues, mirëpo parashtruesi i kërkesës nuk i ka kryer plotësisht pagesat lidhur me borxhin e krijuar nga shfrytëzimi i depos dhe se i njëjti, duke mos e kryer detyrimin e tij që ka rrjedhur pagesa e çmimit për qiranë e papaguar nga shfrytëzimi i depos, i ka mbetur borxh paditësit shumë prej 33,766.01 Euro, me ç'rast ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin NPB-ja e ka cilësinë e kreditorit ndërsa parashtruesi i kërkesës cilësinë e debitorit. Në bazë të këtyre dispozitave, Gjykata e Apelit vlerësoi se ekziston obligimi i të paditurës për pagesën e borxhit në shumën e gjykuar.
34. Kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të pranoj revizionin e parashtruesit të kërkesës, të ndryshojë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët ose të njëjtat t'i prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
35. Në një datë të pasaktësuar, NPB-ja parashtrroi përgjigje në padi, duke propozuar që revizioni i parashtruesit të kërkesës të refuzohet si i pabazuar.
36. Më 10 nëntor 2022, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr.45/2021], refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
37. Në arsyetimin e saj Gjykata Supreme, në paragrafin tre (3) të faqes tre (3) të Aktgjykimit [E. Rev. nr.45/2021], pasi në dispozitiv të Aktgjykimit në fjalë e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, theksoi se: *“Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, për faktin se aktgjykimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare, respektivisht arsyet e dhëna janë kontradiktore me provat nga shkresat e lëndës. Në fakt, gjykata e shkallës së dytë, në aktgjykim nuk ka dhënë arsye se me cilat prova ka konstatuar se i padituri edhe pas periodës sa ka qene lidhur kontrata e qirasë dhe se nuk është vazhduar në heshtje kjo kontratë dhe kjo nënkupton shkëputje të kontratës dhe për këtë periudë nuk pasur detyrimi pagesës së qirasë”*.
38. Më tej në Aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme ndër të tjera theksoi: *“në bazë të dispozitës së nenit 596, par. 1 LMD -së, është e përcaktuar se “kur kalon koha për të cilën është lidhur kontratë e qirasë, qiramarrësi vazhdon të përdorë, sendin, ndërsa qiradhënësi nuk kundërshton këtë, konsiderohet se është lidhur kontratë e re e qirasë me kohëzgjatje të pacaktuar në të njëjtat kushte sikundër edhe ato paraprake”. Se e paditura e ka shfrytëzuar lokalin afarist në fjalë edhe pas skadimit të kontratës dhe nuk ka deklaruar apo nuk ka bërë ndonjë kërkesë të paditësjë se dëshiron të ndërprejë kontratën dhe të dorëzoj lokalin afarist- depon paditësit. Faturat e parashtruara nga paditësi të paditurës për shfrytëzimin e depos për të cilat është deklaruar edhe eksperti financiar, kanë të bëjnë me lokalin në fjalë dhe se e paditura nuk ka kundërshtuar këto fatura, por ka bërë pranimin e faturave të lëshuara nga paditësjë deri më 07.03.2014, kur ka njoftuar paditësin se nuk shfrytëzon lokalin afarist. Prandaj, pretendimet e të paditurës se faturat*

nuk përmbajnë elementet qenësore dhe janë përpiluar në kundërshtim me ligjin nuk qëndrojnë. Njëherit pretendimet se kontratat e qiradhënies kanë të meta të tilla, konform nenit 111 të LMD-së dhe se duhet të rezultuar me rrëzueshmëri të plotë juridike, janë të pabaza nga fakti se e paditura nuk ka kundërshtuar vlefshmërinë e kontratave të qirasë për ndonjë mungesë eventuale për rrëzueshmërinë e tyre. Pretendimi se procesverbali i datës 11.03.2014, ka tiparet e veprës penale dhe është paraqitur fletëparaqitje penale në Prokurorinë Themelore Penale, nuk mund të pranohen nga fakti se nuk është vendosur lidhur me përgjegjësinë penale, ndaj personit përgjegjës të paditurës.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) si dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 1 dhe 2 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial.
40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është përfshirë në shkelje të paragrafit 1 të nenit 182 të LPK-së, duke zbatuar në mënyrë jo të drejtë dispozitat e ligjit të lartpërmendur sepse sipas parashtruesit: *“arsyetimet e aktgjykimeve nxjerre nga gjykatat e rregullta te te " dy instancave, sikundër qe edhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme te Kosovës, janë aktgjykime te formuluar pa pikëmbështetje te nevojshme ligjore, absolutisht te paqarta dhe pa përfshirje te domosdoshme ne shpjegimin e bazës se mirëfillte ligjore dhe faktike te tyre.”* Rrjedhimisht, aktgjykimet e gjykatave të rregullta i konsideron me të meta, për faktin se të njëjtat: *“nuk përmbajnë një përmbledhje të thukët të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit gjyqësor ose në faktet e siguruar nga vetë gjykata, si dhe një deklaram kuptimplotë të bazës ligjore në të cilat objektivisht bazohen aktgjykimet e kundërshtuara”.*
41. Specifikisht, parashtruesi thekson që aktgjykimet e kundërshtuara të të dy instancave përmbajnë të dhëna të paqarta dhe kontradiktore, me mungesë të plotë të arsyetimit, dhe rrjedhimisht, në kundërshtim me dispozitën e nënparagrafit (n) të paragrafit 2 të nenit 182 të LPK-së, duke shtuar se, *“posaçërisht konstatimet e Gjykatës Supreme të Kosovës artikuluar në aktgjykimin e goditur”.*
42. Më tej në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës thekson se atij i janë dorëzuar dy fatura gabimisht nga NPB-ja, fatura të cilat rrjedhimisht sipas tij nuk kishin të bënin asgjë me lokalin afarist depon, objekt lëndor i këtij kontesti, shuma e të cilave nuk është zbritur fare me Aktgjykimin e nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë. Tutje, parashtruesi konsideron se NPB-ja kishte detyrim ligjor që me një deklaratë të thjeshtë të zgjidhte kontratën e qiradhënies, *“dhe atë që në rastin e parë kur të paditurës i ishte dërguar për pagesë qiraje fatura adekuate - dhe pagesa në emër të qirasë nuk ishte kryer brenda afatit tetë (8) ditor. Zgjidhja e Kontratës Qiraje për mospagesë qiraje, si një ndër elementet qenësore të kontratave të dyanshme detyrimore, ka qenë DETYRIM IMPERATIV I PADITËSES, bazuar në parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, parimin bona fides, parimin e keqpërdorimit të të drejtave të tjetrit, si dhe parimin e përkujdesjes që tjetrit të mos i shkaktohet dëm material (Neni 124 LMD (vjetër))”.*

43. Sa i përket lartësisë së gjykuar të detyrimit të tij për pagesë borxhi në emër të qirave të papaguara, parashtruesi i kërkesës thekson që: *“sipas faturave gjegjëse të lëshuara, për periudhën pas dates 31.12.2009 dhe perfundimisht deri me datën 07.03.2014, borxhi pretendues i gjykuar nuk ka assesi mbeshtetje juridike, meqe, ndermjet paleve ndergjyqesore nuk kishte të sendertuara raporte të mirefillta kontraktuale të natyrës ekonomike qiradhenie & qiramarrje, dhe shih për këte nuk kishte as baze juridike detyrimi pagese borxhi nga raporti juridik qiradhenie & qiramarrje”*.
44. Në kërkesën e tij, parashtruesi rithekson se e kundërshton ndryshimin e padisë nga ana e NPB-së, duke konsideruar se është bërë në shkelje të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 257 dhe nenit 258 të LPK-së. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës shpreh dyshimin se në dosjen e lëndës nuk gjendet Procesverbali gjyqësor, me të cilin konfirmohet marrja e vendimit nga gjykata e shkallës së parë për ndryshimin e padisë dhe dhënien e arsyeve për të njëjtin, në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 6 të nenit 258 të LPK-së.
45. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se pas kthimit të lëndës në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, e njëjta gjykatë nuk i ka përfillur vërejtjet dhe të gjeturat e gjykatës së shkallës së dytë, duke nxjerrë Aktgjykimin e goditur, *“pa qartësuar validitetin e provave kontestuese, madje edhe duke u bazuar në kopjet e faturave për të cilat nuk është e qartë nëse gjykatës i janë prezantuar në origjinal, ngase një gjë e tillë nuk është kontestuar në procesverbal”*.
46. Në vazhdim, parashtruesi i kërkesës shton se në rastin e këtij kontesti, padia dhe kërkesëpadia e paditëses, sa i përket borxhit pretendues, tanimë veçse është parashkruar.
47. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson *“Konsiston fakti se aktgjykimet e goditura, janë vendime gjyqësore nxjerre edhe në kundërshtim edhe me KONVENTAT NDERKOMBËTARE dhe DEKLARATËN UNIVERSALE TE TE DREJTAVE TE NJERIUT; KUSHTETUTEN E REPUBLIKES KOSOVES, dhe LIGJIN Nr.2004/3 KUNDER DISKRIMINIMIT te Kosoves {analog dispozitat relevante LIGJI Nr. OS/L-021 PER MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI”*. Në lidhje me këtë theksim, parashtruesi i kërkesës i referohet dhe citon përmbajtjen e nenit 14 të KEDNJ-së, përmbajtjes së *“neni 3 paragrafi 1 pika nen (c) TE KONVENTES PER DISKRIMINIMIN (punësimi dhe profesioni) (sqarim i Gjykatës: parashtruesi i referohet nenit 3 të “Konventës për Diskriminimin”, duke mos specifikuar konventën respektive”*), përmbajtjes së nenit 1 dhe 2 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, si dhe përmbajtjes së *“nenit 2, paragrafit 1 (J) të nenit 4 si dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit,”* dhe i njëjti thekson se në rastin konkret, *“në kundërshtim me parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, parimin e ndalimit të shkaktimit të dëmit tjetrit dhe të kujdesit të mirë (bona fides), si dhe parimit të keqpërdorimit të të drejtës, NPB-ja pa të drejtë konsiston t'i shkaktojë parashtruesit të kërkesës dëm të pariparueshëm material, “me gjasa të qëndrueshme deri në falimentim”*.
48. Parashtruesi i kërkesës konsideron se në rastin e Aktgjykimeve të goditura, *“pa asnjë përjashtim, bëhet fjalë për zbatim të gabuar të së drejtës materiale”*, dhe se të njëjtat ngërthejnë në veti elaborim dhe gjykim të çështjes që ka të bëjë me *“konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”*.
49. Në vijim, parashtruesi vlerëson se mbetja e mëtejme në fuqi e Aktgjykimeve të goditura, jo vetëm që do i shkaktonte dëme të konsiderueshme të natyrës materiale, po ashtu *“rasti i këtyre aktgjykimeve paraqesin edhe pa siguri juridike dhe humbje besimi në gjyqësor,”*

sikundër që nuk do ishte as praktikë e mirë gjyqësore që aktgjykimet e goditura të përdoren më tej si burim që ndihmon gjykatat e rregullta që të interpretojnë në mënyrë të duhur normën ligjore, zhvillimin e procesit gjyqësor dhe kualifikimin e fakteve të secilit rast në mënyrë adekuate”.

50. Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që kërkesa të shpallet e pranueshme për vlerësim kushtetues.

Sqarimet e Gjykatës Supreme

51. Gjykata rikujton edhe një herë se më 24 gusht 2023, kërkoi nga Gjykata Supreme sqarime lidhur me paragrafin në faqen 3 të Aktgjykimit [E. Rev. nr. 45/2021], të 10 nëntorit 2022, të Gjykatës Supreme, respektivisht vendimit të kontestuar i cili rezulton të jetë në kundërshtim me dispozitivin si dhe vet përmbajtjen e tij.
52. Më 29 gusht 2023, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë sqarimet si në vijim:

“Gjyqtari i cili e ka kryesuar kolegjin në procedurën e vendimmarrjes sipas revizionit të paditurës, në aktgjykimin e sipërpërmendur, tanimë ndodhet në pension, për të cilën arsye në mungesë të tij po jap këtë sqarim, duke theksuar si qëndron fakti se ky paragraf 3 i faqes 3 të aktgjykimit tonë E.Rev.nr46/2021 datë 10.11.2022 është në kundërshtim me vendimmarrjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo ky paragraf sipas bindjes sime gjyqtarit i ka mbetur si gabim teknik nga ndonjë aktgjykim tjetër dhe, si i tillë, fare nuk lidhet as me dispozitivin as me arsyetimin e këtij aktgjykimi me të cilën është refuzuar revizioni i të paditurës, ndërsa po që se aktgjykimi i shkallës së dytë apo i shkallës së parë do të ishte i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 182.2, pika n, të LPK-së, atëherë do të duhej domosdo që në kuptim të nenit 223.1 të LPK-së të prishen të dy aktgjykimet apo vetëm njëri prej tyre, mirëpo në këtë rast i tërë arsyetimi tjetër i këtij aktgjykimi ka të bëjë me refuzimin e revizionit duke konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është i drejtë dhe i ligjshëm. Po mendojmë se fjala është për një gabim teknik në të shkruarit e këtij aktgjykimi jo me ndikim të drejtëpërdrejtë në ligjshmërinë e të njëjtit aktgjykim tek i cili e tërë pjesa tjetër e arsyetimit të tij përputhet me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv”.

Dispozitat kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që

janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]"

Neni 13

(E Drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çiftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë

ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

- a) në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;
- b) në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

Neni 257

257.1 Ndryshim të padisë përbënë ndryshimi i njëjtësisë së kërkesëpadiës, zmadhimi i kërkesëpadiës apo parashtrimi edhe i një kërkesë tjetër krahas asaj ekzistuese.

257.2 Padia nuk quhet e ndryshuar po që se paditësi e ka ndryshuar bazën juridike të kërkesëpadiës, po që se e ka zvogëluar kërkesëpadinë, apo po që se i ka ndryshuar, plotësuar apo përmirësuar, thëniet e caktuara në padi.

Neni 258

258.1 Paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare. Në rast të këtillë gjykata të paditurit duhet t'i jep kohë të nevojshme që të përgatitet për shqyrtim të padisë së ndryshuar.

258.2 Pas përfundimit të seancës përgatitore, e më së voni deri në mbylljen e seancës për shqyrtim kryesor, gjykata mund ta lejoj ndryshimin e padisë vetëm po që se konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit dhe po që se i padituri pajtohet me ndryshimin e padisë.

258.3 Konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë po që se ai fillon të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së padisë të ndryshuar, pa e kundërshtuar më parë ndryshimin.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- 53. Gjukata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
- 54. Në këtë drejtim, Gjukata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

55. Gjykata më tej i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

56. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*
57. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridik (shih rastin e Gjykatës Kl41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RiINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe shih rastin Kl26/19, parashtrues *Xhavit Thaqi, pronar i kompanisë "NIP INTERBAJ"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 tetorit 2020, paragrafi 56).
58. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E. Rev. nr. 45/2021] e 10 nëntorit 2022, të Gjykatës së Supreme; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj; si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.

59. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

60. Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit ndërlidhen me një Kontratë mbi qiranë të lidhur në mes të parashtruesit të kërkesës dhe NPB-së, për shfrytëzimin e një lokali afarist depo dhe më pas kjo e fundit parashtrroi padi në Gjykatën Komunale kundër parashtruesit të kërkesës për pagesë borxhi nga baza e kontratës mbi qiranë e lokalit afarist. Pasi që Gjykata Komunale ishte shpallur jokompetente për të vendosur lidhur me rastin, lënda ishte transferuar në Gjykatën Themelore. Gjykata Themelore kishte miratuar në tërësi kërkesëpadinë e NPB-së dhe e kishte obliguar parashtruesin që të paguaj borxhin e përgjithshëm në emër të qirasë në shumën prej 33.766,01 Euro. Pas ankesës së parashtruesit në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit kishte miratuar ankesën dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim. Më tej, Gjykata Themelore duke vepruar në rigjykim miratoi në tërësi kërkesëpadinë e NPB-së dhe e kishte obliguar parashtruesin që të paguaj borxhin e lartcekur, Vendimi i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar më pas nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
61. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara në nenet si në vijim: neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) si dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 1 dhe 2 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial.
62. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, duke pretenduar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë të arsyetuara, përkatësisht kanë mungesë të arsytimit specifik lidhur me pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë. Specifikisht, parashtruesi thekson që: *“Sipas Ligjit, arsytimi i aktgjyqimit me të dhëna të paqarta dhe kontradiktore, siç është rasti i aktgjyqimeve të atakuara, janë të barasvlershme me mungesën e plote të arsytimit, prandaj, edhe nga kjo baze bene të thuhet se aktgjyqimi e kundërshtuara, janë nxjerrje në kundërshtim me dispozitën e Nenit 182 paragrafi 182.2 pika nen (n) të LPK-se.”*
63. Tutje, parashtruesi thekson që: *“Në procedurën para Gjykatës Supreme të Republikës Kosovës, është bërë shkelja e dispozitës së Nenit 182 alineja 182.1 të LPK-se, meqenëse, si Gjykata Supreme njashu edhe gjykatat e rregullta të dy niveleve - pa asnjë përjashtim, kanë zbatuar në mënyrë jo të drejtë dispozitat e këtij Ligji, kurse kjo ka pasur për ndikim në nxjerrjen e një aktgjyqimi të ligjshëm dhe të drejte. Shkelje e dispozitës të procedurës kontesimore ekziston për shkakun sepse aktgjyqimet e goditura, kanë të meta të tilla për shkak të cilave aktgjyqimet në fjalë bëjnë të jone - si të tilla, tërësisht të paqëndrueshme. Të metat e këtyre aktgjyqimeve qëndrojnë për faktin se të njëjtat nuk përmbajnë një përmbledhje të thukët të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjate*

procedimit gjyqësor ose ne faktet e siguruara nga vete gjykata, si dhe një deklaram kuptimplotë të bazës ligjore ne te cilat objektivisht bazohen aktgjykimet e kundershutuara. Eshite rregull dhe parim juridik se aktgjykimi duhet arsyetuar ne menyre te thuket dhe permbajtjesore, gje qe ne rastin e ketij kontesti nuk eshte vepruar.”

64. Nga si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimin përkitazi me zbatim të gabuar të ligjit, në thelb e ndërlidh me mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor. Prandaj, në vijim, bazuar në si më lartë dhe në vlerësimin e asaj nëse e drejta e parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësorë është cenuar, Gjykata fillimisht do të elaborojë (i) parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe më pas (ii) do të aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar

65. Garancitë e mishëruara në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykim, i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 113). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
66. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih rastet e GJEDNJ-së, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim, i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin *Carmel Saliba kundër Maltës*, nr. 24221/13, Aktgjykim, i 24 prillit 2017, paragrafi 73 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 114).
67. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsytetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim, i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, paragrafi 115).
68. Neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim, i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim, i 29 janarit 1999, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, Aktgjykim, i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 116).
69. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë. Është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (shih rastet e GJEDNJ, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, nr. 18390/91, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 117).

70. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:

1. të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, [nr. 61302/00](#), Aktgjykim, i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gjeorgjisë*, [nr. 74644/01](#), Aktgjykim, i 7 qershorit 2006, paragrafi 35); dhe
2. të shqyrtojnë me shumë rigozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollat e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Fabris kundër Francës*, [16574/08](#), Aktgjykim, i 7 shkurtit 2013, paragrafi 72; *Wagner dhe JMËL kundër Luksemburgut*, [nr. 76240/01](#), Aktgjykim, i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).

71. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së, *Burg dhe të tjerët kundër Francës*, nr. [34763/02](#); Vendim, i 28 janarit 2003; *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), [nr. 12686/03](#), Vendim, i 20 marsit 2009, paragrafi 41 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 120).

72. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën e një gjykatë më të lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kukkonen kundër Finlandës* (nr. 2), nr. [47628/06](#), Aktgjykim, i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; *Bufferne kundër Francës*, nr. [54367/00](#), Vendim, i 26 shkurtit 2002 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 121),

73. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. [1509/02](#), Aktgjykim, i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës*, nr. [157/1996/776/977](#)), Aktgjykim, i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 122). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.

(ii) *Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

74. Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore në mënyrë specifike në ndërlidhje me Aktgjykimin [E. Rev. nr. 45/2021], e 10 nëntorit 2022, të Gjykatës së Supreme, të cilin e konsideron me të meta, për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Parashtruesi në mënyrë specifike pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, respektivisht vendimi i kontestuar është përfshirë në shkelje të paragrafit 1 të nenit 182 të LPK-së, duke zbatuar në mënyrë jo të

drejtë dispozitat e këtij ligji të lartpërmendur, duke thekuar se i njëjti përmban arsytetime kontradiktore.

75. Rrjedhimisht, parashtruesi aktgjykimet e gjykatave të rregullta i konsideron me të meta, për faktin se të njëjtat: *“nuk përmbajnë një përmbledhje të thukët të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit gjyqësor ose në faktet e siguruara nga vetë gjykata, si dhe një deklaram kuptimplotë të bazës ligjore në të cilat objektivisht bazohen aktgjykimet e kundërshtuara”*. Tutje, aktgjykimet e kundërshtuara konsideron se përmbajnë të dhëna të paqarta dhe kontradiktore, me mungesë të plotë të arsytimit, dhe rrjedhimisht, në kundërshtim me dispozitën e nënparagrafit (n) të paragrafit 2 të nenit 182 të LPK-së.
76. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet përmbajtjes së nenit 182 të LPK-së, i cili thekson:

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundur të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjyimit të ligjshëm e të drejtë.

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjyimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjyimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjyimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

77. Më tej, Gjykata do t'i referohet përmbajtjes së Vendimeve të gjykatave të rregullta për të vlerësuar nëse ka pasur “arsyetime të mjaftueshëm” në rrethanat e rastit konkret.
78. Gjykata në vijim do të rikujtojë arsyetimin e Aktgjyimit [E. Rev. nr. 46/2021], të 10 nëntorit 2022, të Gjykatës Supreme, përmes së cilit së pari kishte aprovuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e instancave më të ulëta, duke vlerësuar se këto të fundit drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike si dhe drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale. Për më tepër, Gjykata Supreme në arsyetimin e saj shton se: *“në bazë të dispozitës së nenit 596, par. 1 LMD -së, është e përcaktuar se “kur kalon koha për të cilën është lidhur kontratë e qirasë, qiramarrësi vazhdon të përdorë, sendin, ndërsa qiradhënësi nuk kundërshton këtë, konsiderohet se është lidhur kontratë e re e qirasë me kohëzgjatje të pacaktuar në të njëjtat kushte sikundër edhe ato paraprake”*. Se e paditura e ka shfrytëzuar lokalin afarist në fjalë edhe pas skadimit të kontratës dhe nuk ka deklaruar apo nuk ka bërë ndonjë kërkesë të paditësjë se dëshiron të ndërprejë kontratën dhe të dorëzojë lokalin afarist-depon paditësit. Faturat e parashtruara nga paditësi të paditurës për shfrytëzimin e depon për të cilat është deklaruar edhe eksperti financiar, kanë të bëjnë me lokalin në fjalë dhe se e paditura nuk ka kundërshtuar këto fatura, por ka bërë pranimin e faturave të lëshuara nga paditësjë deri më 07.03.2014, kur ka njoftuar paditësin se nuk shfrytëzon lokalin afarist. Prandaj, pretendimet e të paditurës se faturat nuk përmbajnë elementet qenësore dhe janë përpiluar në kundërshtim me ligjin nuk qëndrojnë. Njëherit, pretendimet se kontratat e qiradhënies kanë të meta të tilla, konform nenit 111 të LMD-së dhe se duhet të rezultuar me rrezueshmëri të plotë juridike, janë të pabaza nga fakti se e

paditura nuk ka kundërshtuar vlefshmërinë e kontratave të qirasë për ndonjë mungesë eventuale për rrëzueshmërinë e tyre. Pretendimi se procesverbali i datës 11.03.2014, ka tiparet e veprës penale dhe është paraqitur fletëparaqitje penale në Prokurorinë Themelore Penale, nuk mund të pranohen nga fakti se nuk është vendosur lidhur me përgjegjësinë penale, ndaj personit përgjegjës të paditurës”.

79. Lidhur me pretendimin e parashtruesit para Gjykatës se arsyetimi i Gjykatës Supreme është kontradiktor, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme pasi në dispozitiv të Aktgjykimit refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe konstatoi se Aktgjykimi [Ae. nr. 355/19], i Gjykatës së Apelit, i 8 marsit 2021, është i drejtë dhe i ligjshëm, në vijim thekson: *“Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK-së, për faktin se aktgjykimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare, respektivisht arsyet e dhëna janë kontradiktore me provat nga shkresat e lëndës. Në fakt, gjykata e shkallës së dytë, në aktgjykim nuk ka dhënë arsye se me cilat prova ka konstatuar se i padituri edhe pas periodës sa ka qenë lidhur kontrata e qirasë dhe se nuk është vazhduar në heshtje kjo kontratë dhe kjo nënkupton shkelje të kontratës dhe për këtë periodë nuk ka pasur detyrim të pagesës së qirasë”.*
80. Në ndërlidhje me paragrafin e mësipërm, respektivisht arsyetimin e Vendimit të kontestuar i cili rezulton të jetë në kundërshtim me dispozitivin e të njëjtit, si dhe me vet përmbajtjen e arsyetimit, Gjykata rikujton se lidhur me këtë çështje kjo e fundit kërkoi sqarime nga Gjykata Supreme.
81. Më 29 korrik 2023, Gjykata Supreme, respektivisht gjyqtari SH.S. i Gjykatës Supreme, sqaroi para Gjykatës se gjyqtari i cili e kishte kryesuar kolegjin në rastin konkret tanimë është në pension. Megjithatë gjyqtari SH.S., theksoi se nga vet përmbajtja e Aktgjykimit të kontestuar, vërehet se është fjala për gabim teknik.
82. Nga elaborimi i mësipërm i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës si dhe dispozitave ligjore të lartcekura, në ndërlidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se parashtruesi ngrit pretendime thelbësore në lidhje me trajtimin e çështjes së tij, respektivisht faktit se Vendimi i kontestuar është kontradiktor sepse dispozitivi i të njëjtit nuk është në përputhje me arsyetimin.
83. Në këtë drejtim Gjykata rikujton edhe një herë arsyetimin e gjyqtarit SH.S., të Gjykatës Supreme, i cili para Gjykatës, pas kërkesës së kësaj të fundit, sqaroi se: *“Gjyqtari i cili e ka kryesuar kolegjin në procedurën e vendimmarrjes sipas revizionit të paditurës, në aktgjykimin e sipërpërmendur, tanimë ndodhet në pension, për të cilën arsye në mungesë të tij po jap këtë sqarim, duke theksuar si qëndron fakti se ky paragraf 3 i faqes 3 të aktgjykimit tonë E.Rev.nr46/2021 datë 10.11.2022 është në kundërshtim me vendimmarrjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo ky paragraf sipas bindjes sime gjyqtarit i ka mbetur si gabim teknik nga ndonjë aktgjykim tjetër dhe, si i tillë, fare nuk lidhet as me dispozitivin as me arsyetimin e këtij aktgjykimi me të cilën është refuzuar revizioni i të paditurës, ndërsa po që se aktgjykimi i shkallës së dytë apo i shkallës së parë do të ishte i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 182.2, pika n, të LPK-së, atëherë do të duhej domosdo që në kuptim të nenit 223.1 të LPK-së të prishen të dy aktgjykimet apo vetëm njëri prej tyre, mirëpo në këtë rast i tërë arsyetimi tjetër i këtij aktgjykimi ka të bëjë me refuzimin e revizionit duke konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është i drejtë dhe i ligjshëm. Po mendojmë se fjala është për një gabim teknik në të shkruarit e*

këtij aktgjykimi jo me ndikim të drejtëpërdrejtë në ligjshmërinë e të njëjtit aktgjykim tek i cili e tërë pjesa tjetër e arsyetimit të tij përputhet me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv”.

84. Gjykata konsideron se në rastin konkret sqarimi i dhënë nga gjyqtari SH.S. i Gjykatës Supreme, i cili nuk ishte pjesë e kolegjit gjykues, në Vendimin e kontestuar, nuk adreson në mënyrë të plotë pretendimin e parashtruesit se vet aktgjykimi është kontradiktor sepse dispozitivi i të njëjtit nuk është koherent me pjesën tjetër të arsyetimit. Për më tepër Gjykata vëren se pjesa e arsyetimit e cila rezulton të jetë në kundërshtim me vet dispozitivin, nuk rezulton të jetë çështje thjesht teknike. Kjo për faktin se përmes të njëjtit paragraf me të cilin konstatohet se gjykatat e shkallëve më të ulëta, respektivisht vendimet e tyre kishin rezultuar në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe se të njëjtat nuk përmbajnë arsye për faktet vendimtare, i referohen dhe elaborojnë gjendjen faktike të rastit konkret .
85. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme përmes Vendimit të kontestuar si dhe sqarimit të dhënë nga gjyqtari SH.S. i Gjykatës Supreme, kishte dështuar t’i ofrojë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm pretendimeve të parashtruesit dhe për më tepër i njëjti nuk është koherent siç kërkohet me garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përfshirë të metat procedurale të cilat parashtruesi i ka pretenduar.
86. Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka përcaktuar se gjykatat me juridiksion apeli nuk kanë nevojë të japin arsyetim të detajuar në rastet kur pajtohen me arsyetimin e dhënë nga gjykata e instancës së parë, përkundër faktit që të njëjtat po ashtu duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara (shih rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 31).
87. Megjithatë, Gjykatat e Apelit të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GJEDNJ-së, *Hansen kundër Norvegjisë*, nr. 15319/09, Aktgjykim, i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
88. Nga sa më sipër, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme ka pasur për obligim që t’i adresojë çështjet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, çka në rrethanat e rastit konkret nuk ka ndodhur.
89. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme përtej përshkrimit të gjendjes faktike dhe provave relevante, e njëjta nuk ka arsyetuar pretendimet qendrore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
90. Në fund, Gjykata rithekson se drejtësia procedurale kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur, posaçërisht nëse kanë të bëjnë me pretendimet vendimtare që në rastin konkret i referohen ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës K1202/21, *Kelkos Energy*, SH.P.K., i cituar më lart, paragrafi 140 dhe K1143/22, parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, cituar më lart, paragrafi 139).
91. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk i plotëson kriteret e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të

Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar.

92. Gjykata thekson që konstatimi i Gjykatës, ndërlidhet vetëm me mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, në rastin konkret Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon meritat e rastit.
93. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës ngre pretendime për shkeljen e neneve 3 [Barazia para Ligjit] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNJ-së si dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së. Gjykata nga kërkesa e parashtruesit vëren se lidhur me këtë, ky i fundit vetëm ka përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, duke mos ofruar arsyetim dhe duke mos mbështetur pretendimin e tij rreth mënyrës se si Vendimi i kontestuar, përfshirë edhe vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, mund të kenë rezultuar në shkeljen e këtyre të fundit.
94. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, si dhe nenin 13 dhe 14 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 45 (2) (b) dhe 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 shtator 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [E. Rev. nr. 45/2021], e 10 nëntorit 2022, të Gjykatës Supreme;
- IV. TA KTHEJË për rishqyrtim Aktgjykimin [E. Rev. nr. 45/2021], e 10 nëntorit 2022, të Gjykatës Supreme, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës, deri më 19 mars 2025, për masat e ndërmarra për zbatimin këtij Aktgjykimi;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- VII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani